



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 20.05.2013
Nr. 463-613

PËR: Lulzim Rrustemi Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit

LËNDA: Përgjigje në shkresë

Të nderuar

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar kërkesën për interpretim ligjor, lidhur me këmbim të pronës komunale me pronë private me qëllim të realizimit të projektit me interes publik Sheshi "Adem Jashari".

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit e kërkesës vlerëson se;

- Duke u bazuar në nenin 11, të Ligjit nr. 04/L144, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, me qëllim të realizimit të interesit publike, komunat kanë të drejtë të bëjnë këmbimin e pronës komunale me pronë private.
- Kuvendi i Komunës bazuar me propozimin e kryetarit të komunës për interes publik merr vendim paraprak për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronë të personave fizik dhe juridik;
- Me rastin e këmbimit të pronës së paluajtshëm komunale me persona fizik dhe juridik, vlerësimin i pronave të cilat janë objekt i këmbimit, bëhet nga organi kompetent përkatësisht Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme, në kuadër të Ministrisë së Financave, ashtu siç është paraparë me nenin 3 pika 1. 13 si dhe paragrafin 6 të nenit 11 të Ligjit nr. 04 L-144, Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.
- Pas sigurimit të vlerësimit financiar, Kuvendi i Komunës merr vendim përfundimtar për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronën e personave fizik dhe juridik;

- Rezultatet e këmbimit duhet publikuar dhe duhet të përmbajnë të dhënat e pronave të këmbyera, vlerën e tyre si dhe emrin e pronarit.

MAPL, është e përkushtuar të ofrojë përkrahje dhe ndihmën e nevojshme, për zbatimin e legjislacionit për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër & Ministër i MAPL,-së



Kopje: *Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së*
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana: 20.05.2013
Br. 463-613

Za: Lulzim Rrustemi Predsedavajući Skupštine Opštine Lipjane

Predmet: Odgovor na dopisu

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, je primila zahtev za zakonsko tumačenje , u vezi sa razmenom opštinske imovine sa privatnom imovinom u cilju realizovanja projekta od javnog interesa Trg "Adem Jashari".

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja zahteva procenjuje ;

- Na osnovu člana 11, Zakona br. 04/L144, za davanje na korišćenje i razmenu nepokretne opštinske imovine, u cilju realizovanja javnog interesa, opštine imaju pravo da izvrše razmenu opštinske imovine sa privatnom imovinom.
- Skupština Opštine na osnovu predloga gradonačelnika opštine za javni interes prethodno odlučuje za razmenu nepokretne opštinske imovine sa privatnom imovinom pravnim i fizičkim licima;
- Prilikom razmene nepokretne opštinske imovine za pravnim i fizičkim licima, procenjivanje imovine koja je objekt razmene se vrši od nadležnog organa odnosno Kancelarija za Procenjivanje Nepokretne Imovine u sklopu Ministarstva Finansija, onako kako je predvidjeno po članu 3 tačka 1. 13 i paragrafom 6 člana 11 Zakona br. 04 L-144, za davanje na korišćenje i razmenu nepokretne opštinske imovine.
- Posle obezbeđivanja finansijake procene, Skupština Opštine donori završnu odluku za razmenu nepokretne opštinske imovine sa imovinom pravnih i civilnih lica ;
- Rezultate razmene treba objaviti i treba da sadrže podatke o razmenjenoj imovini, njihovu vrednost kao i ime vlasnika .

MALS, je opredeljeno da ponudi podršku i potrebnu pomoć, za spovodjenje zakonodavstva za lokalnu samoupravu u Republiku Kosovo.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera & Ministar MALS-a



Kopija: *Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a*
Rukovodiocima Uprava MALS-a
Arhivu MALS-a.